

KOMUNA E SHTIMËS

Nr. 03/1174

Datë 01.11.2018

KONTRATË

(SHËRBIM)

PJESA I E KONTRATËS

Komuna Shtime Rr. „ Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131- ose 045-444-509 të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit në njëren anë;

dhe

N.T.P. „ Ardhmëria „, Shtime të cilën e përfaqëson **Dashnim Jashari** nr. i tel 044-228-437 në anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

“Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonës dimrore”

me numër identifikues: **617-2018-101-221**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

“Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonës dimrore”

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve është : 27,304.50 €

(Njëzetë e shtatë mijë e treqindë e kater euro e pesëdhjet centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbënë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofriuesit te Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Ofriuesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Havë QARRO
Pozita:	U.D. Menaxher Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	01.11.2018
Vula:	

Për Ofriuesin e Shërbimeve

Emri:	Dashnim Jashari
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	01.11.2018
Vula:	



PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do lë thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit Kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Në rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve përvendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti Kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit Kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues përmiratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërpriren e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:

- Autoriteti Kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njofojt Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë *madhore*" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës *madhore* do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përrnë bush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës *madhore*. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës *madhore*.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës *madhore* ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës *madhore* të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet la bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershmët të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një pale të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të regullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumë që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe t'i veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhe t'i veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimesh t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të

veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitet janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kérkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tëpërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do lë, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do lë ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë

formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofrcuesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofrcuesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofrcuesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit Kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Ofrcuesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë puniën e ofrcuesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofrcuesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofrcuesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofrcuesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defekti të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofrcuesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofrcuesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofrcuesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofrcuesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kérkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofrcesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkakuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofrcesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofrcesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofrcesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofrcesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES **KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura përenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]


Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : 02.11.2018
	6.4	Data e Përfundimit është 30.04.2019
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : Të gjitha rrugët e cekura në paramasë.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : Gojart Bajrami
Dëmet likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës. Data e sigurimit te ekzekutimit :30.05.2019
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së Kontratës.
Sigurimi që do	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:

të merret nga ofruesi i shërbimeve		Për humbje ose dëmtim të impianteve dhe Materialeve 1. humbje ose dëmtim i Pajisjeve 2. humbje ose dëmtim i pronës 3. dëmtim personal ose vdekje (i) të punëtorëve të Kontraktuesit (ii) të personave të tjera Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa OE do ti bëhen në bazë të situatave , për shërbimin e kryer , të aprovuara nga menaxheri i kontratës .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Palet kontraktuese do ti bejne te gjitha perpjekjet për ti zgjidhur mosmarrveshjet që mund te ndodhin ndërmjet tyre në mënyrë miqësore .nëpërmjet ZKA-së</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovë.

**Paramasa për pastrimin e rrugëve lokale nga bora dhe akulli në Komunën e
Shtimes
Sezoni dimëror**

A	Pastrimi i borës dhe akullit në të gjitha rrugët dhe rrugicat e Komunës së Shtimes dhe hudhja e kripës në rrugët e asfaltuara				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma
1	Rrugët e fshatit Petrovë				
	Rr. Ademi	Metra	400	0,15	60,00
	Rr. Avdush Ademaj	Metra	1400	0,15	210,00
	Rr. Beqa	Metra	300	0,15	45,00
	Rr. Fadil Rashiti	Metra	1400	0,15	210,00
	Rr. Gjyteti	Metra	250	0,15	37,50
	Rr. Haqif Hysenaj	Metra	1100	0,15	165,00
	Rr. Haxhi Zeka	Metra	400	0,15	60,00
	Rr. Ilirisë	Metra	80	0,15	12,00
	Rr. Imer Hysenaj	Metra	120	0,15	18,00
	Rr. Kadri Ademaj	Metra	800	0,15	120,00
	Rr. Kruja	Metra	450	0,15	67,50
	Rr. Lumi	Metra	300	0,15	45,00
	Rr. Mehdi Korranı	Metra	700	0,15	105,00
	Rr. Nazim Bakiu	Metra	500	0,15	75,00
	Rr. Qamil Osmanı	Metra	550	0,15	82,50
	Rr. Tringë Ismajli	Metra	200	0,15	30,00
	Rr. Xhemshir Xhemshiri	Metra	1200	0,15	180,00
2	Rrugët e fshatit Mollopolc				
	Rr. Zona Nerodimes	Metra	700	0,15	105,00
	Rr. Islam Neziraj	Metra	1300	0,15	195,00
	Rr. Kukësi	Metra	800		
	Rr. Brigjet e Lirisë	Metra		0,15	120,00
	Rr. Sadik Mujota	Metra	2200	0,15	330,00
	Rr. Hyrë Emini				
	Rr. Abedin Murtezi	Metra	400	0,15	60,00
	Rr. Drita Mujota	Metra	450	0,15	67,50
	Rr. Neziraj	Metra	600	0,15	90,00
	Ruga Mollopolc –Guri i Kishës	Metra	1300	0,15	195,00

Adresa: Rr. Tahir Sinani nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës
 Tel.: +381290389016 ex 121 email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



	Rruga Mollo poc – Jezerc (Rr. Abdyl Selami)	Metra	900	0,45	435,-
3	Rrugët e fshatit Reçak				
	Rr. William Voker	Metra	1600	0,45	720,-
	Rr. 15 Janari	Metra	1400	0,45	610,-
	Rr. Lidhaj Prizerenit	Metra	1200	0,45	540,-
	Rr. Ahmet Kaqiku	Metra	1200	0,45	540,-
	Rr. 28 Nëntori	Metra	600	0,45	270,-
	Rr. Dëshmorët e Reçakut	Metra	1400	0,45	610,-
	Rr. Besa Besë	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. 24 Marsi	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Baza e UÇK-së	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Pavarësia	Metra	300	0,45	135,00
4	Rashincë – Gllavicë				
	Rr. Ferizaj	Metra	2400	0,45	1080,-
	Rr. Galica	Metra			
5	Rrugët e fshatit Rashincë				
	Rr. 11 Marsi	Metra	600	0,45	270,-
	Rr. Trimat e Lirisë	Metra	1200	0,45	540,-
	Rr. Qorrolli	Metra	500	0,45	225,-
	Rr. Haxhiu	Metra	500	0,45	225,-
	Rr. Ibrahim Kodra	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Buna	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Cani	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Rexha	Metra	100	0,45	45,-
	Rr. Beqir Rushiti	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Osman Qorrolli	Metra	90	0,45	40,50
6	Rrugët në fshatin Muzeqinë				
	Rr. Lazgush Poradeci	Metra	400	0,45	180,-
	Rr. Zeqë Zeqiri	Metra	100	0,45	45,-
	Rr. Isuf Hoxha	Metra	500	0,45	225,-
	Rr. Haxhi Halimi	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Ibrahim Shahini	Metra	500	0,45	225,-
	Rr. Shahini	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Veteranët i Lirisë	Metra	300	0,45	135,00
7	Rrugët e fshatit Gjurkovcë				
	Rr. Pjetërshtica	Metra	100	0,45	45,-
	Rr. Besim Sopa	Metra	750	0,45	337,50
	Rr. Arifi	Metra	300	0,45	135,00

Adresa: Rr. Tahir Sinani nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës
 Tel.: +381290389016 ex 121 email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>




	Rr. Ulpiana	Metra	400	0,45	180,-
	Rr. Bushati	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Hoxhë Sinani	Metra	800	0,45	360,-
8	Rrugët e fshatit Pjetershticë				
	Rr. Musolli	Metra	2100	0,45	945,-
	Rr. Isak Brahimi (plus segmentet)	Metra	700	0,45	315,-
	Rr. Izet Ajeti (plus 2 segmente)	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. Lagjja e Re	Metra	300	0,45	135,-
	Rr. Idriz Ajeti	Metra	1300	0,45	585,-
	Rr. Aziz Dugolli	Metra	1100	0,45	495,-
	Rr. Mehmet Arifi (plus segmentet)	Metra	600	0,45	270,-
	Rr. Qazim Ferati	Metra	150	0,45	67,50
	Rr. Beqir Bajrami	Metra	100	0,45	45,-
	Rr. Dushkaja	Metra	150	0,45	67,50
	Rr. Tafil Musolli (plus segmentet)	Metra	450	0,45	202,50
	Rr. Shaqë Dugolli	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. Pashtriku (segment)	Metra	100	0,45	45,-
	Rr. Rrezja	Metra	350	0,45	157,50
9	Rrugët e fshatit Belincë				
	Rr. Istref Emini, Rr. Nysret Abazi dhe Rr. Selim Selimi	Metra	800	0,45	360,-
	Rr. Emrushi	Metra	900	0,45	405,-
	Rr. Marie Shllaku	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Skënderbeu	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. Gjon Buzuku	Metra	500	0,45	225,-
	Rr. Lekë Dukagjini	Metra	300	0,45	135,-
	Rr. Aziz Kelmendi	Metra	450	0,45	202,50
10	Rrugët e fshatit Carralevë				
	Rr. Avdyli	Metra	600	0,45	270,-
	Rr. Grajqevci	Metra	400	0,45	180,-
	Rr. Tërpeza	Metra	300	0,45	135,-
	Rr. Xheladin Xheladini	Metra	300	0,45	135,-
	Rr. Balaj	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. Besheniku	Metra	750	0,45	345,-
	Rr. Zeka	Metra	800	0,45	360,-
11	Rrugët e fshatit Godanc				


Adresa: Rr. Tahir Sinani nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës

Tel.: +381290389016 ex 121 email: info@shtime-komuna.org

<http://kk.rks-gov.net/shtime>




	Rr. Shefket Muhadini Rr. Buqinca Rr. Dëshmorët e Godancit	Metra	2700	0,45	405,-
	Rr. Arsim Zeqiri Rr. Jete Qadraku Rr. Idriz Rexhepi Rr. Besëlidhja	Metra	2400	0,45	1080,-
	Rr. Muhxheria	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. 17 Shkurti	Metra	600	0,45	270,-
	Rr. Agron Ramadani	Metra	500	0,45	225,-
	Rr. Kadolli	Metra	300	0,45	135,-
	Rr. Vllezërit Hyseni	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. Qadraku	Metra	100	0,45	45,-
	Rr. Mbretëresha Teutë	Metra	1000	0,45	450,-
	Rr. Emin Troshupa	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Gashi	Metra	650	0,45	297,50
	Rr. Tmava	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Qazim Mikullovci	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Sopjani	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Balli Kombëtar	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Nëntori i Dytë	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Carraleva	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Reçica	Metra	260	0,45	117,-
	Rr. Dardania	Metra	470	0,45	211,50
	Rr. Popova	Metra	250	0,45	112,50
	Rr. Dragusha	Metra	300	0,45	135,-
12	Rrugët e fshatit Zborc				
	Rr. Sokol Dauti	Metra	550	0,45	247,50
	Rr. Sadri Badra	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Sadik Muharremi	Metra	200	0,45	90,-
	Rr. Blinaja	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Ruzhdi Salihu Rr. Hafir Bajrami	Metra	6000	0,45	2700,-
13	Rrugët në Shtime				
	Rr. 2 Korriku	Metra	350	0,45	157,50
	Rr. Hysiqi(<i>deri te pompat e ujësjellëit</i>)	Metra	850	0,45	382,50
	Rr. 12 Qershori (<i>deri në fund të rrugës</i>)	Metra	900	0,45	405,-
	Rr. Isa Boletini	Metra	700	0,45	315,-
	Rr. Milaim Beha	Metra	700	0,45	315,-
	Rr. Afrim Musliu	Metra	130	0,45	58,50
	Rr. Ismail Qmajli	Metra	1500	0,45	675,-




Rr. Ahmet Shtimja	Metra	550	0,15	32,50
Rr. Përparim Boshnjaku	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Afrim Selmani	Metra	200	0,15	30,00
Rr. Imer Devetaku	Metra	700	0,15	105,00
Rr. Jetë Hasani	Metra	600	0,15	90,00
Rr. Mehmet Mustfa	Metra	250	0,15	37,50
Rr. 14 Dhjetori	Metra	800	0,15	120,00
Rr. Ymer Prizreni	Metra	200	0,15	30,00
Rr. Arben Hyseni	Metra	400	0,15	60,00
Rr. Dr. Vezir Bajrami	Metra	100	0,15	15,00
Rr. Sylejman Vokshi	Metra	200	0,15	30,00
Rr. Enver Gashi	Metra	800	0,15	120,00
Rr. Adem Jashari (<i>deri te rrathi</i>)	Metra	1800	0,15	270,00
Rr. Eqrem Qabej	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Luigj Gurakuqi	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Avni Rrustemi	Metra	100	0,15	15,00
Rr. Nexhat Ramadani	Metra	140	0,15	21,00
Rr. Skender Qarri	Metra	240	0,15	36,00
Rr. Kadri Syla	Metra	200	0,15	30,00
Rr. Shaqir Berisha	Metra	100	0,15	15,00
Rr. Komandendant Kumanova (<i>deri te rrathi</i>)	Metra	1450	0,15	217,50
Rr. Sami Frashëri	Metra	450	0,15	67,50
Rr. Sefë Kosharja	Metra	250	0,15	37,50
Rr. Nënë Tereza	Metra	250	0,15	37,50
Rr. Ardhmëria	Metra	120	0,15	18,00
Rr. Fan Noli	Metra	100	0,15	15,00
Rr. Sahide Metushi	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Elmi Kameri	Metra	160	0,15	24,00
Rr. Lutfi Bilalli	Metra	180	0,15	27,00
Rr. Esat Mekuli	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Cajupi	Metra	140	0,15	21,00
Rr. Asdreni	Metra	100	0,15	15,00
Rr. Mic Sokoli	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Zenun Beqa	Metra	150	0,15	22,50
Rr. De Rada	Metra	200	0,15	30,00
Rr. Ramadan Elshani	Metra	150	0,15	22,50
Rr. 7 Marsi	Metra	200	0,15	30,00
Rr. Shaqri Tershana	Metra	300	0,15	45,00
Rr. Emin Musliu	Metra	150	0,15	22,50
Rr. Afrim Syla	Metra	140	0,15	21,00
Rr. Sadik Osmani	Metra	400	0,15	60,00
Rr. Ragip Bajrami	Metra	120	0,15	18,00

Adresa: Rr. Tahir Sinani nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës
 Tel.: +381290389016 ex 121 email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



	Rr. Gjergj Fishta	Metra	120	0,15	18,00
	Rr. Anton Qetta	Metra	1070	0,45	481,35
	Rr. Enver Rashiti	Metra	350	0,15	52,50
	Rr. Marin Barleti	Metra	90	0,15	13,50
	Rr. Ernest Koliqi	Metra	250	0,15	37,50
	Rr. Rexhep Murati	Metra	120	0,15	18,00
	Rr. Shotë Galica	Metra	100	0,15	15,00
	Rr. Kuvendi Arbit	Metra	350	0,15	52,50
	Rr. Tahir Sinani (<i>deri te rrathi</i>)	Metra	1400	0,15	210,00
	Rr. Faik Konica	Metra	150	0,15	22,50
	Rr. Skender Salihaj	Metra	1900	0,15	285,00
	Rr. Industria	Metra	500	0,15	75,00
14	Lagja Pajtimit				
	Rr. Ilira	Metra	400	0,15	60,00
	Rr. Ohri	Metra	500	0,15	75,00
	Rr. Besim Ndrecaj	Metra	250	0,15	37,50
	Rr. Fazli Grajqevci	Metra	150	0,15	22,50
	Rr. Çamëria	Metra	1000	0,15	150,00
	Rr. Tepelena	Metra	150	0,15	22,50
15	Rrugët e fshatit Davidove				
	Rr. Smajl Gorani	Metra	700	0,15	105,00
	Rr. Imer Syla	Metra	400	0,15	60,00
	Rr. Emini	Metra	300	0,15	45,00
	Rr. Sadriu	Metra	170	0,15	25,50
	Rr. Demokracia	Metra	300	0,15	45,00
	Rr. Baftiu	Metra	200	0,15	30,00
16	Rrugët e fshatit Vojnovc				
	Rr. Fejzullahu	Metra	2000	0,15	300,00
	Rr. Bashkim Emini	Metra	160	0,15	24,00
	Rr. Ulqini	Metra	160	0,15	24,00
	Rr. Shabani	Metra	300	0,15	45,00
	Rr. Mehmeti	Metra	350	0,15	52,50
	Rr. Ramadani	Metra	250	0,15	37,50
	Rr. Jashari	Metra	500	0,15	75,00
17	Rr. Avdyl Avdiu	Metra	300	0,15	45,00
18	Rr. Hysen Rexhepi, Topillë	Metra	5500	0,15	825,00
19	Rr. Hamëz Devetaku deri te rr. Egnatia në Llanisht	Metra	2500	0,15	375,00



20	Rr. Brigada 123 dhe Rr. Manastiri Llanishtë- Topillë	Metra	1500	0,15	225,..
21	Rruga Carralevë-Karaqicë	Metra	5500	0,15	825,..
22	Rruga Karaqicë- Dugë	Metra	2000	0,15	300,..
23	Rr. Egnatia, Luzhak – Llanishtë	Metra	7000	0,15	1050,..
24	Carralev - Rancë	Metra	3000	0,15	450,..


$\Sigma A = 20449,50$

B	Pastrimi i borës nga trotuaret				
	Bora duhet të largohet nga trotuarët dhe nga hyrjet e të gjitha shkollave, sa herë të jetë e nevojshme.				
	Rr. Milaim Beha, Carralevë	Metra	1000	0,15	150,..
	Rr. Skënderbeu, rreth Pishave	Metra	800	0,15	120,..
	Rr. Afrim Musliu, Belincë	Metra	1000	0,15	150,..
	Rr. 15 Janari, Reçak	Metra	710	0,15	106,50
	Rr. Maliq Hoxha, Muzeqinë	Metra	900	0,15	135,..
	Rr. Lasgush Poradeci, Muzeqinë	Metra	180	0,15	27,..
	Rr. Anton Cetta, Shtime	Metra	1100	0,15	165,..
	Rr. Trimat e Lirisë, Rashincë	Metra	130	0,15	19,50
	Rr. Ferizaji, Rashincë	Metra			
	Rr. Tahir Sinani, Shtime	Metra	3200	0,15	480,..
	Rr. Adem Jashari, Shtime	Metra	3000	0,15	450,..
	Rr. Komandant Kumanova, Shtime	Metra	1200	0,15	180,..
	Rr. William Voker, Shtime	Metra	1300	0,15	195,..
	Rr. Skender Salihaj, Shtime(deri te hyrja e shkollës)	Metra	450	0,15	67,50
	Rr. Isa Boletini	Metra	500	0,15	75,..
	Rr. Shefket Muhadini	Metra			
	Rr. Dëshmorët e Godancit	Metra	2000	0,15	300,..
	Rr. 12 Qershori	Metra	600	0,15	90,..
	Rr. Afrim Selmanaj	Metra			

$\Sigma B = 2710,50$


Gjithsej A+B **$23160,00$**

D	Pastrimi i borës nga Parqet dhe Varrezat				
	Bora duhet të largohet nga Parqet dhe Varrezat sa herë të jetë e nevojshme				
	Parqet	Metra	200	0,30	60,..
	Varrezat	Metra	300	0,30	90,..



E	Pastrimi i shkallëve nga bora dhe akulli					
	Bora duhet të largohet nga shkallët sa herë të jetë e nevojshme					
	Shkallët në rrugën Ahmet Shtimja që qojnë te shkolla fillore Emin Duraku	Metra	50	1,00	50,00	
	Shkallët që qojnë te shkolla Skënderbeu në Reçak	Metra	50	1,00	50,00	
						$50 = 100,00$
						Gjithsej D+E: 250,00
F	Hudhja e kripës					
	Kripa hidhet në rrugë sipas nevojës gjatë sezonit dimëror					
	Kripë	T	148	26,315	3894,50	
						Gjithsej A+B: 23160,00
						Gjithsej D+E: 250,00
						Gjithsej F: 3894,50
						Totali i Çmimit 27304,50

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	117P. ARDHMERIA
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	DASHNIH JASHARI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	22/10/2018
VULA:	



 13 NOV 2018